



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 191/14 Prot.

Tiranë, më 29/03/ 2018

Lënda: Masat e marra lidhur me sigurimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme dhe afatgjatë të çështjes së strehimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, në zonën e Selitës në Tiranë.

Drejtuar: **Z. ERION VELIAJ**
KRYETAR
BASHKIA TIRANË

TIRANË

I nderuar z. Veliaj!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është njohur me shqetësimin e disa familjeve rome dhe egjiptiane¹, që vendbanimet e tyre u prekën nga ndërtimi i Unazës së Madhe në zonën e Selitës. Familjet rome dhe egjiptiane deri në periudhën Mars 2018 trajtohen me qira dy vjeçare në bazë të VKM nr. 230, datë 13.03.2015 “ *Për trajtimin me qira për disa familje që preken nga zbatimi i projektit: Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit- Rr. Kavajes*” të ndryshuar.

Lidhur me këtë problematike, në vitin 2016 Komisioneri, nëpërmjet Vendimit nr. 114, datë 22.06.2016², ka rekomanduar marrjen e masave nga Këshilli i Ministrave dhe institucionet e tjera përgjegjëse për sigurimin e strehimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë për familjet e

¹ Nëpërmjet letres Nr.191 Prot, date 01.02.2018

² Ky vendim i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është rrezuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Komisioneri e ka ankimuar këtë Vendim në Gjykatën Administrative të Apelit.

komunitetit rom dhe egjiptian, përpara mbarimit të afateve të vendosura në VKM nr. 230, datë 13.03.2015.

Duke pasur parasysh, se trajtimit me qera i familjeve përfundon në Mars 2018, do të vlerësonim nesë na informoni me masat që janë marrë nga ana e Bashkisë Tiranë, lidhur me sigurimin e një strehimi të përshtatshëm për familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian, në zonën e Selitës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

IRMA BARAKU

